



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ prot

Tiranë, më ____, ____, 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

OPERATORIT EKONOMIK “PC STORE ” SHPK

Adresa: Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur (mall).**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në ambientet publike të Tiranës”, me Nr. reference REF-87686-11-14-2023** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i kontratës*): Buletini Nr. 2 datë 15 Janar 2024

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i fituesit paraprak*): Buletini Nr. 95 datë 20 Nëntor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Bashkimi i operatorëve ekonomik “AlbaScan” sh.p.k, NIPT L71416010E dhe “A E S S” sh.p.k, NIPT J61814007G**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 11,375,000 (njëmbëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

- **Operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k, NIPT L01606034A**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 8,634,000 (tetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë) lekë.

Nga pjesërmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92, pika 3 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

- I. Referuar “Kritereve të Vecanta të Kualifikimit”, konkretisht pika 2.2.2, ku sipas së cilës kërkohet: *“Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021, 2022), të paraqitur në autoritetet përkatëse, Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”*,

rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar Operatori Ekonomik “AlbaScan” sh.p.k, anëtar i BOE “AlbaScan” sh.p.k & “A E S S” sh.p.k, ka paraqitur në SPE, *Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021, 2022)*, por të pashoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar sipas kërkesave të këtij kriteri. Konkretisht, referuar nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 ku citohet se:

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.*

si dhe nga verifikimi i Kopjeve të certifikuara të bilanceve të paraqitura nga operatori ekonomik “AlbaScan” sh.p.k, rezultoi se ky OE është në kushtet e nenit të sipërcituar **për dy vite radhazi** 2021 dhe 2022, pasi për këto vite **tejkalohe**n treguesit :

- i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh.*

Referuar sa më sipër OE “AlbaScan” sh.p.k nuk ka paraqitur Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar sipas kërkesave të kriterit 2.2.2 të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit të dokumentave standarde të tenderit për këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi.

- II. Në kriterin 2.3.7 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional, të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, Autoriteti Kontraktor kërkon:

“2.3.7 Operatori ekonomik duhet të zotërojë licencë profesionale të shoqërisë, e vlefshme, për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuar me ligj, me kategoritë e mëposhtme:

- NS 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në Republikën e Shqipërisë. (Mbështetur në Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr.42, datë 16.01.2008).”

Në Procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, pjesë e dokumenteve të tenderit Autoriteti Kontraktor citon:

... “

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP; në nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për të realizuar objektin e kontratës. Kërkesa e mësipërme për licencim në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi, është në përputhje me natyrën ku ndërthuret furnizimi i mallrave me instalimet dhe vendosjen e tyre si dhe në përputhje me volumin e kontratës. Përcaktimi i kategorisë së licensave është bërë duke patur parasysh specifikimet teknike, preventivin e volumet, larmishmërinë e zërave të punës (**Instalime elektrike, instalime dhe mirembajtje rrjeti lan, fibre, etj.**). Përcaktimi i nivelit të klasifikimit është vendosur (A) bazuar në vlerën e preventivit sipas zërave përkatës i cili nuk e kalon nivelin deri në 20 milion lekë, të përcaktuar....”

Në dokumentin “Akt Marrëveshje Bashkimi të Përkohshëm të Shoqërive”, dorëzuar në spe Operatori Ekonomik “AlbaScan” sh.p.k deklaron se merr përsipër të kryejë:

Artikulli	Përshkrimi i shëbimit	Sasia
I. Furnizimi, instalim, konfigurim, integrim i komponentëve të infrastrukturës (HW + SW)		
2	F.V Switch	24
3	F. V Kabëll Rrjeti	2500
4	F. V Kabëll elektrik	700
5	F.V Fiber optike	2500
8	F.V Kabinete metalike outdoor	24

dhe A E S S sh.p.k deklaron se merr përsipër të kryejë:

Artikulli	Përshkrimi i shëbimit	Sasia
I. Furnizimi, instalim, konfigurim, integrim i komponentëve të infrastrukturës (HW + SW)		
1	F.V Access Point	56
6	F.V Licensa për AP	56
7	F.V Licensë për portal regjistrimi/ login page	1
II. Mirëmbajtje dhe suport i komponentëve hardware dhe software të infrastrukturës (ekzistuese + e re)		
1	Shërbimi i mirëmbajtjes e suportit	24

Për sa më sipërcituar, referuar argumentimit të kriterit, zërave që ka marrë përsipër të realizojë, Operatori Ekonomik “AlbaScan” sh.p.k, anëtar i BOE “AlbaScan” sh.p.k & “A E S S” sh.p.k, duhet të paraqiste në spe dokumentin vërtetues “Liçencë profesionale të kategorisë “NS 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni”, duke qenë se ka marrë përsipër të realizojë furnizimin dhe vendosjen për zërat si kabëll rrjeti, fiber optike, kabinete metalike outdoor etj. Referuar sa më sipër, BOE “AlbaScan” sh.p.k dhe “A E S S” sh.p.k nuk përmbush kriterin 2.3.7 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të dokumentave standarde të tenderit për këtë procedurë prokurimi.

- III. Në shtojcën 8, të DST- së objekt prokurimi, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit , A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT është kërkuar si më poshtë vijon:

Ofertuesi deklaron se: *“Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____”

Referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “A E S S” sh.p.k (anëtar i BOE “AlbaScan” sh.p.k & “A E S S” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi objekt vlerësimi), në cilësinë e administratorit janë deklaruar znj. Armanda Përleka dhe z. Ardit Myftari, ndërsa në cilësinë e ortakut është deklaruar z. Lefter Klemo. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “AESS” sh.p.k ka dorëzuar shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, ku referuar *Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, pika A: “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”,* rezulton se ka deklaruar znj. Armanda Përleka dhe z. Ardit Myftari në cilësinë e administratorit, por jo z. Lefter

Klemo në cilësinë e “*Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*”, pra nuk ka deklaruar personin në cilësinë e ortakut të shoqërisë “A E S S” sh.p.k. Në gjykim të KVO, në shtojcën 8 të DST, formati i miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik, kërkon që të citohen “*Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*”, pra emrat konkret të të gjithë personave që kanë rol vendimmarrës pranë shoqërisë përkatëse pra, administratorët dhe ortakun e shoqërisë në rastin e OE “A E S S” sh.p.k., duke iu referuar gjëndjes faktike të ekstraktit të regjistrit tregtar të këtij të fundit. Sa më sipër, KVO gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “A E S S” sh.p.k, anëtar i BOE “AlbaScan” sh.p.k & “AESS” sh.p.k” nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij nuk është plotësuar Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas kërkesave të përcaktuara.

Në vijim, KVO konkludon njëzëri se BOE “AlbaScan” sh.p.k, & “A E S S” sh.p.k, s’kualifikohet Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e BOE “AlbaScan” sh.p.k, & “A E S S” sh.p.k, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë te pavlefshme.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “PC Store”shpk**, me adresë: Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Çmimi total i ofertës pa TVSH = 8,634,000 (tetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë) lekë pa tvsh se është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____